



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

**TATIMI NË TË ARDHURA TË KORPORATAVE- ULJA E NORMËS SË
TATIMIT NGA 20% NË 10%**

**UDHËZUES PËR MËNYRËN E APLIKIMIT TË NORMËS SË RE
TATIMORE**

Janar, 2009

HYRJE

ULJA E NORMËS PREJ 20% NË 10%

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Me këtë Ligj është ulur norma e tatimit në të ardhura të korporatave nga 20% në 10%. Norma e re hyn në fuqi prej 1, Janarit 2009 dhe ky ndryshim prek çdo tatimpagues të regjistruar për Tatimin në të Ardhura të Korporatave dhe i cili tatóhet në bazë të të Ardhurave Reale.

QËLLIMET E KËTIJ UDHËZUESI

Ky udhëzues do ti ndihmojë tatimpaguesit të cilët paguajnë Tatimin në të Ardhura të Korporatave, për mënyrën e aplikimit të normës së re tatimore. Prandaj Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës dëshiron të inkurajoj dhe asistoj bizneset në mënyrë që ato të bëjnë ndryshimet e nevojshme në lidhje me ndryshimin e normës.

ASISTENCA E MËTEJME

Nëse keni ndonjë pyetje në të cilën ju nuk keni qenë në gjendje të gjeni përgjigje brenda përmbajtjes së këtij udhëzimi, ju lutem kontaktoni Departamentin e Edukimit të Tatimpaguesve në Zyrën Qendrore të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kontaktet:

Tel. 038 200 25 017

Email : info@atk-ks.org

Web : www.atk-ks.org

Ky shërbim është në dispozicion prej 8.30 deri në 15,30 prej të hënës deri në të premten.

1. TATIMPAGUESIT TË CILËT DUHET TË DEKLAROJNË DHE PAGUAJNË TATIMIN NË TË ARDHURA TË KORPORATAVE.

- 1.1 Një korporatë apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;
- 1.2 Një ndërmarrje afariste që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;
- 1.3 Një organizatë e regjistruar si Organizatë Joqeveritare në bazë të legjislacionit mbi regjistrimin dhe punën e Organizatave Joqeveritare në Kosovë;
- 1.4 Një person jo-rezident me njësi të përhershme në Kosovë.

2. TATIMPAGUESIT TË CILËT NUK PREKEN NGA NDRYSHIMI I NORMAVE TATIMORE

- 2.1 Kompanitë e sigurimit do të vazhdojnë që të aplikojnë Tatimin në shkallën 7% të Premive Bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore. Norma prej 7% është norma që ka qenë e aplikueshme edhe më parë për Kompanitë e Sigurimit. Ligji i për Tatimin në të Ardhura të Korporatave nuk e ka ndryshuar këtë normë tatimore.
- 2.2 Tatimpaguesit të cilët nuk i kanë kaluar të ardhurat bruto vjetore prej 50 000 eurove si dhe ata të cilët nuk e kanë kaluar këtë limit dhe nuk kanë zgjedhur që në baza vullnetare të taten në bazë të të hyrave reale. Kjo nënkupton se kjo kategori e tatimpaguesve do të vazhdojë të paguajë këstet e tyre tremujore duke përllogaritur normat e njëjta sikur më parë :
 - a. Tatimpaguesit me 5.000 euro, apo më pak të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste - 37.5 euro për tremujor;
 - b. Tatimpaguesit me mbi 5.000 deri në 50.000 euro të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste, :
 - b.1. Tre për qind (3%) të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori,
 - b.2. Pesë për qind (5%) të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori.

3. TATIMPAGUESIT TË CILËT PREKEN NGA NDRYSHIMI I NORMAVE TATIMORE

3.1 Tatimpaguesit të cilët i kanë kaluar të ardhurat bruto vjetore prej 50 000 euro, obligohen që të taten në bazë të të hyrave reale.

3.2 Tatimpaguesit të cilët nuk i kanë kaluar të ardhurat bruto vjetore prej 50 000 euro, por të cilët kanë zgjedhur që të taten në bazë të të hyrave reale.

4. PAGESA E KËSTEVE TREMUJORE PËR TATIMPAGUESIT TË CILËT PREKEN NGA NDRYSHIMI I NORMAVE TATIMORE

4.1 Tatimpaguesit të cilët i takojnë nenit 3 të këtij udhëzuesi, të cilët zgjedhin që të paguajnë këstet e tyre tremujore për vitin 2009 në baza të parashikimit, pagesa e kësteve do të bëhet duke aplikuar shkallën 10% në fitimin e paraparë. **Fitimi i paraparë** do të jetë rezultati i ndryshimit në mes të **ardhurave të parapara për Periudhën Tatimore pjesëtuar me 4 dhe shpenzimeve të parapara për Periudhën Tatimore pjesëtuar me 4.**

4.2 Tatimpaguesit të cilët i takojnë nenit 3 të këtij udhëzuesi, të cilët zgjedhin që të paguajnë këstet e tyre tremujore për vitin 2009 në baza të strehës së sigurt (110% të detyrimit tatimorë të periudhës së vitit të kaluar), pagesa e kësteve do të bëhet duke llogaritur: **{(detyrimi tatimorë i vitit të kaluar pjesëtuar për 2) * 110%} pjesëtuar për 4.**

Shembull:

Detyrimi tatimor i viti 2008 i cili do të jetë rezultat i deklaratës vjetore të Tatimit në të ardhura të Korporatave është = 10,000 euro.

$10,000 / 2 = 5,000$ euro do të jetë baza për llogaritëse për pagesën e kësteve të vitit 2009.

$5,000 \times 110\% = 5.500$

$5.500 / 4 = 1375$ është pagesa që do të bëhet me secilin këst për vitin 2009

5. DEKLARIMI DHE PAGESA E DEKLARATËS TATIMORE VJETORE

- 5.1 Tatimpaguesit të cilët duhet të përgatisin Deklaratën Tatimore vjetore për vitin 2008 e të cilën duhet ta dorëzojnë deri me 1 prill të vitit 2009, në fitimin e tyre të tatueshëm që është rezultat i kësaj deklarate, do të aplikojnë normën tatimore 20%.
- 5.2 Tatimpaguesit të cilët duhet të përgatisin Deklaratën Tatimore vjetore për vitin 2009 e të cilën duhet ta dorëzojnë deri me 1 prill të vitit 2010, në fitimin e tyre të tatueshëm që është rezultat i asaj deklarate, do të aplikojnë normën tatimore 10% .

6. APLIKIMI I NORMËS TATIMORE ME RASTIN E MBAJTJES NË BURIM TË TATIMIT

- 6.1 Tatimpaguesit të cilët duhet të mbajnë tatimin në burim sipas nenit 27.1 të Ligjit mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, me rastin e pagesës apo të kreditimit (për muajt nga janar 2009 e më pas) të dividendës, kamatës apo përqindjes së fitimit (nga e drejta e autorit, e patentës apo e shfrytëzimit të burimeve natyrore), duhet të mbajnë në burim tatimin në shkallën 10% .
- 6.2 Tatimpaguesit të cilët duhet të mbajnë tatimin në burim sipas nenit 27.2 të Ligjit mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, me rastin e pagesës apo të kreditimit (për muajt nga janar 2009 e më pas) të qirasë duhet të mbajnë në burim tatimin në shkallën 9 % . Edhe pse në nenin 27.2 është paraparë që tatimi të mbahet në burim me normën 10%, Tatimpaguesit duhet të mbajnë tatimin në burim për qira në normën 9% për këto arsye:
- a) Qiraja është e tatueshme sipas paragrafit 1.3 të nenit 6 të Ligjit mbi Tatimin në të Ardhura Personale;
 - b) Sipas paragrafit 2.2 të nenit 10 të Ligjit mbi Tatimin në të Ardhura Personale, nga qiraja bruto do të zbriten 10% në emër të shpenzimeve të lejueshme dhe pastaj në neto qira do të aplikohet norma prej 10% . Rezultat i kësaj do të jetë pagesa e qirasë në shkallën 9% nga qiraja bruto.
- 6.3 Tatimpaguesit të cilët sipas nenit 17 të Ligjit mbi Tatimin në të Ardhurat Personale, obligohen që të mbajnë në burim tatimin në paga, këtë do ta bëjnë duke llogaritur tatimin nën pagën e tatueshme të paguar në periudhën Janar 2009 e tutje me këto shkallë tatimore:

Paga mujore e tatueshme	Norma e tatimit e shprehur në %
0 deri 80	0%
80 deri 250	4%
250 deri 450	8%
Mbi 450	10%

6.4 Tatimpaguesi i cili nuk është punëdhënës kryesor dhe do të paguajë pagë dytësore për të punësuarin e tij në muajin janar 2009 e tutje, do të mbajë në burim tatimin në shkallën maksimale 10%

7. MËNYRA E PËRLLOGARITJES SË ZHVLERËSIMIT DHE TRAJTIMI I JOREZIDENTËVE

7.1 Me rastin e shndërrimit, nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, të Rregullores 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave në Ligjin mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, nuk janë përfshirë ndryshimet që janë bërë me Rregulloren 2005/51 e cila e ka ndryshuar Rregulloren 2004/51 mbi TAK-në, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e përllogaritjes së zhvlerësimit. Për këtë arsye, ju duhet që në momentin që do të përllogaritni zhvlerësimin në pasqyrat e juaja financiare të vitit 2008 e tutje, do të aplikoni mënyrën e paraparë me Rregulloren 2005/51 dhe Udhëzimin nr 2/2008 të datës 24.04,2008 mbi aplikimin e Rregullores 2005/51. Pra kjo do të thotë se :

- a) Rregullorja 2005/51 e datës 16 dhjetore 2005 mbetet e aplikueshme
- b) Udhëzimi nr 2/2008 i datës 24.04,2008 mbi aplikimin e Rregullores 2005/51 mbetet i aplikueshëm

7.2 Gjithashtu me rastin e shndërrimit, nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, të Rregullores 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave në Ligjin mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, nuk janë përfshirë ndryshimet që janë bërë me Rregulloren 2007/22 e të cila ka të bëjnë me trajtimin e njërive të përhershme. Gjithashtu edhe kjo Rregullore do të mbetet e aplikueshme.

8. PËRDORIMI I FORMULARËVE PËR PAGESË

Nëse Administrata Tatimore, për shkak të kohës së shkurtër që ka, nuk do të jetë në gjendje të ju furnizojë me formularë të rinj tatimore për pagesë të tatimit apo mbajtje në burim të tatimit në të cilat duhet të jenë të korrigjuara normat tatimore të aplikueshme, ju mund ti përdorni formularët e vjetër duke bërë korrigjimet me dorë mbi vendet ku janë të përshkruara normat e vjetra tatimore.

Një shembull të korrigjimit me dorë e gjeni të bashkangjitur në këtë udhëzues.

JANAR 2009



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

PASQYRA MUJORE E MBAJTJES NË BURIM DHE PAGESËS SË TATIMIT NË INTERES, DIVIDENTË, TË DREJTA PRONËSORE, QIRA, FITORE NË LOTARI DHE LOJRA TË FATIT

WR

UNIREF

[2]

[1] Periudha e Dorëzimit:

[3] Numri i Regjistrimit të Mbjtësimit në Burim:

[4] Emri i Mbjtësit

[4]

[5] Adresa e mbjtësit
(veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)

[5]

Telefoni

[6] Emri i Personit të Kontaktit

[6]

Telefoni

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.

Shtesë

Korrigjim

Vetëm pagesë

a. Tatimi i mbajtur në burim në interes, dividendë, të drejta pronësore dhe marrjet në lotari

[8] Interesi bruto i paguar për muajin -----

[8]

[9] Dividenti bruto i paguar për muajin -----

[9]

[10] Të drejtat pronësore të paguara për muajin (vetëm joindividëve)

[10]

[11] Fitoret në lotari bruto të paguara për muajin (vetëm individëve)

[11]

[12] Shuma totale e paguar për muajin [12]=[8]+[9]+[10]+[11]

[12]

[13] Tatimi i mbajtur në burim përveç qirasë [13]=[12] x 20% ~~10%~~ -----

[13]

b. Tatimi i mbatur në burim mbi qiratë

[14] Qiraja bruto e paguar për muajin -----

[14]

[15] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë e paguara [15]=[14] x ~~16%~~ 9%
(vetëm qiramarresit jo -individualë) -----

[15]

[16] Tatimi total i mbajtur në burim [16]=[15]+ [13]-----

[16]

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula

dd/mm/vv

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula

Numri i llogarisë: 1000420070000373

[17] Shuma e tatimit të paguar

Teksti:

Data ____/____/____

€